

**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN**

Drejtoria Komunale për Prokurim Publik  
VU644-24-8493-5-2-5/C900  
14 Nr. 596/24  
Dt. 29.08.2024

## KONTRATË PUNE

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Ilmi Azemi – Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejshëm **PORORSITËSI**), dhe
2. **BVD GROUP SH.P.K, emri i biznesit** me seli në Prishtinë, me ARBK : 812074483, të cilën e përfaqëson z. **Vedat Musliu** , në tekstin e mëtejshëm: **KRYESI I PUNËVE**, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punët e shënuara me poshtë:

**Renovimi i Zyreve të Kadastrit në Komunën e Vushtrrisë - Ritender**, me numër identifikues:

Nr. i prokurimit	VU644	2	4	84	9	3	5	2	5
Nr. i brendshëm	VU644	2	4	0	6	6	5	2	5

### Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve nga ana e Kontraktuesit, si vijon :ka të bëjë me **Renovimi i Zyreve të Kadastrit në Komunën e Vushtrrisë -**.
- 1.2 Afati i fillimit të punimeve është ditën e nënshkrimit të kontratës, në rast se kushtet vlerësohen të përshtatshme për punë.
- 1.3 Projekti do të realizohet brenda periudhës 7 ditë, sipas kushteve të kontratës të përcaktuara në Kushtet e Veçanta të Kontratës dhe rezultati nga procesi i negociomit.
- 1.4 Kryesi i punimeve ka të drejtë në shtyrje të afatit të kryerjes së punimeve në rast të ndikimit të fuqisë madhore, vonesës së Porositësit në përmbushjen e obligimeve kontraktuese dhe atë për aq ditë sa kanë zgjatur rrethanat që e kanë shkaktuar vonesën.
- 1.5 Nëse Kryesi i Punëve/Shërbimeve, me përgjegjësinë e tij, nuk arrin t'i përfundoj ndonjë ose të gjitha punët/ shërbimet e kontraktuara brenda afatit kohorë të specifikuar në këtë kontratë, Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon pas skadimit të afatit të përfundimit të punimeve/shërbimeve sipas kësaj Kontrate dhe datës së përfundimit punëve /shërbimeve të kontraktuara, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,10% në ditë të vlerës së punëve/shërbimeve të pa përfunduara - dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës

### Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: 19,524.40 € ( nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqindnjëzetekatërpikëdyzet (Euro/cent).

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen : në pajtim me punët e aprovuara nga Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrës i Menaxherit të Kontratës i Autoritetit Kontraktues.

2.4 Pagesa do të kryhet pasi Kontraktuesi të ketë përfunduar punimet dhe Komisioni i Pranimiit Teknik të ketë lëshuar Raportin për pranimin teknik të punimeve të përfunduara me Situacion të nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrës i Menaxherit të Kontratës i Autoritetit Kontraktues.

### **Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (f) Plani për menaxhimin e kontratës;
- (g) Procesverbali i mbledhjes së informatave/vizitës së vendit
- (h) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

### **Neni 4 Komunikimet**

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cëkin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.



4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe<sup>1</sup> në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

---

<sup>1</sup> Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

Për : Autoritetin Kontraktues – Komuna Vushtrri

Për O.E. : “ BVD Group “sh.p.k. – Vushtrri

<b>Emri:</b>	<b>Ilmi Azemi</b>	<b>Emri:</b>	<b>Vedat Musliu</b>
<b>Pozita:</b>	Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik	<b>Pozita:</b>	Drejtor
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	29.08.2024	<b>Data:</b>	29.08.2024
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik  
14 Nr. 604/24  
Dt. 30.08.2024

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik / Nr.A01, në bashkëpunim dhe propozim dhe të Përgjegjësit të Njësisë Kërkuese – Drejtorin e Arsimit dhe Drejtorit të Drejtorisë për Prokurim Publik, më dt. 30.08.2022 merë:

**V E N D I M**

1. Caktohet Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës për përmbushjen në mënyrë të rregullt të kontratës që për lëndë ka: “ **Renovimi i Zyrave të Kadastrit të Komunës së Vushtrrisë**”, me numër të prokurimit: **VU644-24-8493-525** dhe numër të brendshëm të prokurimit **VU644-24-066-525**, si vijon :

**z. Sabri Dallku** , caktohet menaxher i kontratës.  
**z. Remzi Ahmeti**, caktohet Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës,

2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Neni 61 të Rregullave dhe Udhëheqësit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës.

**Përgjegjësitë dhe funksionet e Menaxherit të Projektit / Kontratës, janë me sa vijon, të :**


- Menaxhoi obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në Kontratë;
- Sigurojë që Op. Ek. i përmbushë të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Op. Ek. e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbushë gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë se ka kontroll adekuate të kostove, cilësisë dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- Sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së Kontratës;
- Sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen siç kërkohet;
- Nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta marr miratimin;
- Jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit;
- Dorëzoj raporte mbi progresin ose kompletimin e një kontratë, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga Zyrtari Kryesor administrativ;
- Në pajtim me nenin 61.7 të rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës i A. K. duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të filloj me fazat e menaxhimit të projektit / Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë Menaxheri i projektit/ kontratës brenda afatit optimal/ të arsyeshëm kohorë, jo më gjatë se dy ditë pune, duhet të krijoj një Plan për Menaxhim të kontratës duke përdorur funksionin " Fillimi / rnobilizimi i kontratës". Plani i menaxhimit të kontratës do të krijohet nga Sistemi i prokurimit elektronik në bashkëpunim mes Menaxherit të kontratës të A.K. dhe O.E. - Kontraktuesit, duke e nënshkruar të dyja palët. Menaxheri i Projektit do ta përcjell një kopje të Planit për menaxhimin e kontratës Departamentit të Prokurimit. Pasi Zyrtari përgjegjës i Prokurimit pranon Planin për menaxhim të kontratës , Menaxheri i Projektit do të lëshoj Op. Ek. kontraktuesit letrën për fillimin e punëve, kryen edhe punë tjera të nevojshme, sipas dokumentit të ofertës, kushteve të kontratës, përgjegjësi të përcaktuara si në Kushtet Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës, pjesë përbërëse e Dosjes së tenderit.

**Përgjegjës dhe funksionet e Mbikëqyrës të Menaxherit të Projektit/ Kontratës, janë me sa vijon :**

- mbikëqyrja e drejtpërdrejtë e implementimit të kontratës;
- administrimi i plotë i kontratës, përfshirë çfarëdo ndryshimi eventual të kontratës, dhe
- rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit- vlerësim të propozuar nga menaxheri i kontratës nën mbikëqyrjen e tij.

3. Vendimi hyn në fuqi dhe zbatohet ditën e marrjes ndërsa, për bazë do të ketë zbatimin e përpiktë të kontratës mes Autoritetit Kontraktues – Komunës së Vushtrrisë dhe Operatorit Ekonomik: **“ BVD Group SHPK ”, me seli në Vushtri.**

Kopje: Menaxheri i Kontratës;  
Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës;  
Drejtoria e Prokurimit;  
Drejtoria të Njësisë Kërkuese

  
\_\_\_\_\_  
Kryetar Komunes



REPUBLIKA E KOSOVES - KOMUNA E VUSHTRRIS



PARAMASA DHE PERLLOGARIA PER RENOVIMIN E ZYREVE TE KADASTRIT NE KOMUNEN E VUSHTRRIS

Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin dhe montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancionin si dhe kompletimin e certifikatave dhe atesteve të prodhuesve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i tërë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Bazuar edhe në Emërtimin e Dokumentit sasitë e prezantuar janë të Parallogaritura. Punëkryesi duhet të prezantoj përmes Librit Ndërtimorë Vlerat Reale Organit Mbikqyrës për Verifikim dhe Evolvim.

A	PARAMASA E PUNËVE NDËRTIMORE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI NJËSI	TVSH -18 %	ÇMIMI NJËSI ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1	<b>PUNET PARAPRAKE</b>						
1.1	Organizimi i punishtës në kordinim me drejtorin përkatës për ekzekutimin e punimeve	koplet	1.00	100.00	€ 0.18	118.00	118
1.2	Kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve të rrjetit si kanalizimit, ujesjellesit në hapsirat e zyreve dhe banesave mbi zyretë kadastrit përfshirë edhe përdheshen në haspirat e, BPB e cila konsiderohet me se ka probleme me rrjedhjet e ujit dhe kanalizimit, evidentimi duhet të bëhet me aparat të veçantë i cili dedikohet rrjedhjen.	koplet	1.00	400.00	€ 0.18	472.00	472
1.3	Përgatitja e ekzekutimit të punimeve pa epengura zhvillimin e punëve zyrtare, banorve dhe zyrev përkatëse në përdheshë	koplet	1.00	145.00	€ 0.18	171.10	171.1
TOTALI:							761.1
2	<b>PUNET E DEMOLIMIT</b>						
2.1	Demolimi i plafoneve nga pllaktë e gipsit, materiali i demoluar të ngarkohet dhe transportohet në deponi legale	m <sup>2</sup>	46.00	2.50	€ 0.18	2.95	135.70
2.2	Demolimi i me kujdes i plafoni të varuar amstrong	m <sup>2</sup>	38.00	2.20	€ 0.18	2.60	98.80
2.3	Demolimi me kujdes i dyshemes lamint, materiali i demoluar të ngarkohet dhe transportohet në deponi	m <sup>2</sup>	93.00	1.60	€ 0.18	1.89	175.77
2.4	Demolimi me kujdes i kërmikes në muret dhe dyshme të nyjeve sanitare në hapsirat e zyrev dhe në banjot e banesave sipër zyrev që janë evidentuar që rrjedhin ujë dhe kanalizim, materiali i	m <sup>2</sup>	67.00	4.50	€ 0.18	5.31	355.77
2.5	Gryja e murve të brendshme dhe përgatitja për fazat tjera në vazhdim, materiali i gryer të ngarkohet dhe transportohet në vendin e caktuar	m <sup>2</sup>	589.00	1.55	€ 0.18	1.83	1,077.87
2.6	Demolimi i rrjetit të ujesjellesit dhe kanalizimit sipas nevojës në zyret, nyjeve sanitare dhe banjot sipër zyrev	koplet	1.00	200.00	€ 0.18	236.00	236.00
TOTALI:							2,079.91
3	<b>PUNET E RIPARUESE</b>						
3.1	Rishikimi i rrjetit të ujesjellesit dhe kanalizimit në tërësi duke intervenuar pjesërisht në rrjetin e kanalizimit, hapjen e kanalizimit duke përdorur makineri me presion për deblokim vertikal dhe përdorimi i materialeve si silikona, vazhdim të gypit.	koplet	1.00	800.00	€ 0.18	944.00	944
3.2	Furnizimi me material dhe montimi i pllakave të gipsit me trashësi t=1.5cm përshirë konstrukcionin vares në plafonet e caktuara, në këtu pozicionin të përfshihet edhe tharja e hapsirave ku do të vendostet pllafoni	m <sup>2</sup>	46.00	32.00	€ 0.18	37.76	1736.96
3.2	Furnizimi me material dhe montimi i rrjetit të kanalizimit me Ø 100,50, në hapsirat e nyjeve sanitare	m'	7.50	10.00	€ 0.18	11.80	88.5
TOTALI:							2769.46
4.1	Furnizimi me material dhe montimi i rrjetit të ujesjellesit me gypa të zingurë 6V4 me gjatësi mesatare 3.20m në këtu pozicionin të përfshihet edhe punët e demolimit atyje ekzistues duke bërë prerjen, hapjen e filatave në vendin e caktuar për vazhdim për funksionalizim dhe testimi	m'	3.1	90	€ 0.18	106.20	329.22
4.2	Furnizimi, punimi me material dhe izolimi i gypit 6V4 me materialin adekuat për izolim	m'	21.00	20.00	€ 0.18	23.60	495.6

4.3	Furnizimi me material dhe montimi armaturave te rrethit egzistues si						
4.4	ekx ventili 112-318	copw	2.00	8.00	€ 0.18	9.44	18.88
4.5	Kapak te wc koplet	cope	1.00	50.00	€ 0.18	59.00	59.00
4.6	Furnizim me material dhe montimi kasetes diemnishte 40x60cm , n w kwtw pozcionw tv pwrfsihet edhe punet e demolimit , murit ormanit pwr oren e ujit , dhe punet tjera per funksionalizim	copw	1.00	151.53	€ 0.18	178.81	178.81
4.7	Furnizimi dhe montim te gypave nga betonarmeja Ø600mm per qarkullim te ujit nga Kanali perqate rruges deri te Lumi.Ne qmim te kalkulohen germimi i dheut me largim, mbulim me zhavor (0-31.5) dhe kokat hyrese dhe dalese me beton C-25/30 Armatura rret Ø8-10/10cm	m	22.00	35.00	€ 0.18	41.30	908.60
4.8	Furnizimi me material dhe montimi ventilatoarve nw hasiral e banojve n w kwtw pozcionw tv pwrfsihet furnizimi me rryme, dhe lidhja me abientit me gypa Ø100	copw	3.00	40.00	€ 0.18	47.20	141.60
4.9	Furnizimi me material dhe montimi i keramikave nw muret e banojve dhe dyshme, me materialin ngjitesit tv jet i kualitetit tv iartw	m²	67.00	29.00	€ 0.18	34.22	2,292.74
4.10	Furnizimi me material dhe montimi i laminabit i ngjashume me ate egzistues me trasheti t=8mm	m²	75.00	15.00	€ 0.18	17.70	1,327.50
4.11	Furnizimi me material dhe montimi i grillave nw dyret e banojve dhe zyres sw akivil me dimensione 10x200cm ng a material i plastikes	copë	4.00	12.00	€ 0.18	14.16	56.64
4.12	Furnizimi me material dhe montimi i derw nga materi pvc kombinim hekur m e diemnsione 70x2.10m , n w kwtw pozcion w tv pwrfsihet punwte demolimit, harnimit nw tvrw permitrit e derws	copw	1.00	250.00	€ 0.18	295.00	295.00
4.13	Furnizimi me material dhe montimi i plafoneve tv varuer armstrong	m²	67.00	13.00	€ 0.18	15.34	1,027.78
4.14	Furnizimi me material dhe lryja me baze nw dy shtresa e mureve	m²	589.00	2.54	€ 0.18	3.00	1,767.00
4.15	Furnizimi me matral dhe gjetimi i sipwrfaqeve tv mureve dhe plafoneve nw dy shtresa pwrfsihet edhe pwrqdfiten pwr ngjyrosje	m²	589.00	2.90	€ 0.18	3.42	2,014.38
4.16	Furnizimi me material dhe lryja me bazw ne dy shtresa	m²	67.00	2.80	€ 0.18	3.30	221.10
4.17	Furnizimi me material piktolorw ekologjik n w dy shtresa	m²	589.00	4.00	€ 0.18	4.72	2,760.08
TOTALI							13,913.93

REKAPITULIMI		totali €
1	PUNET PARAPRAKE	€ 761.10
2	PUNET E DEMOLIMIT	€ 2,079.91
3	PUNET E RIPARUESE	€ 2,769.46
4	PUNET E RIPARUESE	€ 13,913.93
Totali me TVSH		€ 19,524.40

### PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë : <b>Ligji në fuqi në Republikën e Kosovës.</b>
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë : <b>gjuhët zyrtare në vend.</b>
sigurisë së tenderit	9.1	N/A
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është : <b>10 % ( dhjetë përqind) e vlerës së përgjithshme të kontratës.</b> <b>Dokumenti - Polisa e sigurim apo dokument bankar të lëshuar nga ndonjë kompani e sigurimeve apo bankë të licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës me afat validiteti për kohëzgjatjen e periudhës 40 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.</b>
Përgjegjësia dhe Sigurimi Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Implantëve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda <b>2 ( ditë )</b> ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është: konform planit dinamik të dorëzuar sipas afatit të përcaktuar paraprakisht.

Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë : menjehere nga data e nënshkrimit të kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë: 0.10 % të çmimit përfundimtar të Kontratës, për ditë të vonuar.  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Kontraktuesi – Kryesi i Punimeve dhe Menaxheri i Projektit i Autoritetit Kontraktues do të mbajnë Ditarin e Punës dhe Librin Ndërtimor, gjatë gjithë kohës së ekzekutimit të kontratës, për të evidentuar të gjitha përshkrimet e punimeve të ekzekutuara në terren, për të konfirmuar sasinë dhe cilësinë e materialeve të përdorura në objektet – vend punishte, gjithashtu për të evidentuar ecurinë e punimeve, pengesat eventuale, aktivitetet e ndërmarra për eliminimin e pengesave të shfaqura, kohëzgjatjen e kohës sa kanë zgjatur pengesat dhe në fund, pas përfundimit të punimeve, për të dhënë një Rekapitulim të ecurisë së punimeve përmes të dhënave në shifra dhe data.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit: do të emërohet me vendim të veçantë nga Zyrtari Kryesor Administrativ i Autoritetit Kontraktues, pas nënshkrimit të kontratës.  Do të jetë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe mbikëqyrjen e cilësisë, sasisë dhe përshtatshmërisë së punimeve në objekt, në pajtim me dispozitat e saktësuara si në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës dhe detyrat e përshkruara në vendimin mbi emërimin.  Poashtu, Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, me vendim do të cakton një zyrtar për mbikëqyrjen e realizimit të projekteve.
Pagesa	24.1	Pgaesa do të kryhet në afatin sa më të shkurtër kohor, por jo më gjatë se 30 ditë nga data e pranimit dhe evidentimit të faturës nga zyrtari përgjegjës për pranimin dhe protokolimin e faturave i AK-së.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: <b>N / A</b>
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: <b>N / A</b>
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë : 10 ditë , duke filluar pas nënshkrimit të kontratës dhe fillimit të punimeve.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është : Periodha garantuese e defekteve është 12 muaj, duke filluar nga data e pranimit teknik të përkohshëm, në shumë prej 10 % të vlerës së përgjithshme të kontratës, për defektet e paraqitura në objekt.  Dokumentit - Policës së Sigurimit të kualitetit të punëve e lëshuar nga një Bankë ose Kompani e Sigurimeve e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës, me afat të validitetit për kohëzgjatjen e periudhës prej 13 muaj, duke filluar nga data e pranimit teknik të punëve.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është : përqindja e vlerësuar e punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe

me procedurë gjyqësore		ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë – <b>Departamenti për Çështje Ekonomike</b> , në pajtim me ligjin në Kosovë.
------------------------	--	---